

LIGJ
Nr. 31/2014

**PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE
SPECIALE OPERACIONALE TË POLICISË SË SHËTETIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Punonjësit e strukturave speciale operationale të Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë, për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 2

Sigurimi i shëndetit për punonjësit e strukturave speciale operationale të Policisë së Shtetit bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon shpenzimet për kontrollin parandalues, diagnostikues dhe kurues, të ofruara nga institucionet shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit.

Efekti financiar i këtij ligji mbulohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 3

Kategoria e punonjësve të strukturave speciale operationale të Policisë së Shtetit që kanë të drejtë të bëjnë sigurimin e veçantë të shëndetit, sipas këtij ligji, lista e shërbimeve shëndetësore, si dhe autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore, rast pas rasti, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8542, datë 21.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani